


2.4 MBUSHËS PËR FUGA 3 - 20 mm

FUGARAPID



Njësia matëse	copë/kuti	Konsumi
5 kg/qese	4 copë/kuti	0.2-1 kg/m ²



FUGA RAPID 3 - 20

Stuko me bazë çimento me tharje të shpejtë, me granulometri të lartë për mbushjen e fugave deri në dimensione 20 mm.

KARAKTERISTIKAT

Material në formë pluhuri me bazë çimento, pluhur guri natyral, rezina sintetike, aditiv special hidrofobik, pigmente ngjyrues me rezistencë të lartë ndaj alkaleve dhe detergjentëve. Është rezistente ndaj dritës dhe ka aftësi të ruajë ngjyrën e saj origjinale. Në bazë të klasifikimit sipas EN 13888 i përket klasës së CG2-WA.

Karakterizohet nga:

- Punueshmëri dhe hapje mjaft e mirë.
- Pastrohet lehtësisht.
- Në përfundim të jep një sipërfaqe të lëmuar.
- I papërshkueshëm nga uji.
- Rezistencë e lartë kundrejt bazave (alkaleve) dhe detergjentëve.
- Rezistencë ndaj gërryerjes (korrozionit).
- Rezistencë ndaj rrezatimit UV.
- Parandalon procesin e efloreshencës.
- I disponueshëm në 24 ngjyra.

SPECIFIKIMET

Stukot që përdoren për mbushjen fugave në dysheme dhe në mure me përmasa 3 - 20 mm duhet të stukohen me mbushës me bazë çimento të qëndrueshëm ndaj ujit (me një absorbim të ujit më pak se 2 gs/m² / minutë përcaktuar sipas normës EN 13888) e tipit Fuga Rapid.

FUSHA E PËRDORIMIT

Fuga RAPID 3 - 20 mm përdoret në rastet si më poshtë:

Stukimi i fugave midis pllakave prej qeramike poroze, monocotto, bicotto, gres porcelani dhe gur natyral me hapësirë 3 - 20 mm. Për stukimin e dyshemeve dhe veshjeve të jashtme, kur kërkohet një rritje e papërshueshmërisë, elasticitetit dhe forcës mekanike, për sipërfaqe me vibrim, për sipërfaqe me bymim - tkurrje (tarraca, dysheme me ngrohje, pishina, shatervane etj.) stuko Fuga Rapid duhet përforcuar me 500 gr. aditiv DW 17 të holluar me 700 - 1000 ml. ujë për një qese Fuga Rapid 5 Kg.

MËNYRA E PËRGATITJES

Në një ene hidhni 1 - 1.5 L ujë dhe 5 Kg Fuga RAPID. Përziejini me një përzierës elektrik me një numër të vogël xhiros, derisa të fitohet një masë homogjene. Rekomandohet që masa të lihet në qetësi për afro 5 minuta dhe të përziehet përsëri përpara aplikimit të produktit. Kur duhet të bëjmë përforcimin e Fugacolor me aditivin DW 17 përpara hollojmë 500 gr. DW 17 në një ene me 700 - 1000 ml ujë dhe më pas, zbrazim ngadalë pluhurin e Fuga FAST të cilin e përziejmë në të njëjtën mënyrë si më lartë.



TE DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

Forma	Pluhur Kokrrizor
Ngjyra	Shih tabelën e ngjyrave, I disponueshëm në 24 ngjyra
Ruajtja	24 muaj në paketim original në vend të thatë
Djegshmëria	I padjegshëm
Raporti i përzierjes	1 - 1,5 litra ujë për 5 Kg Fuga Rapid 3 - 20 mm
Dendësia e përzierjes	2 gr/cm ³
pH i përzierjes	12
Konsistenca e përzierjes	Pastë e rrjedhshme
Temperatura e aplikimit	+5°C deri +35°C
Kohëzgjatja e përzierjes	2 orë
Kalueshmëria	pas 3 orësh
Mbushja e fugave në mure	pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në mure pas ngjitjes me Dw 2200 Rapid	pas 3 orësh
Mbushja e fugave në dysheme	pas 24 deri 36 orësh
Mbushja e fugave në dysheme pas ngjitjes me Dw 2200 Rapid	pas 3 orësh

